REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org. Jedinica / Org. Unit: SP-02
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 4565-2/24
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No. Pages: 04
Data / Datum / Date: 12.11.24
PRISHTINË / A
No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 17.10.2024 |
| REFERENC-Ë: | 24/4565/MMPHI |
| PËR/ZA/TO: | "M-Shkodrani" Sh.p.k., Gjilan<br>Qendër grumbulluese të mbeturinave metalike, automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre, Shillovë, Gjilan. |
| CC: | Komisioni për Leje Mjedisore |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Afrim Murati, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim për vazhdim të Lejes Mjedisore |

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore për vazhdim të operatorit, "M-Shkodrani", Sh.p.k., Gjilan, me nr. prot. 24/4565/MMPHI, me veprimtarinë: Qendër grumbulluese të mbeturinave metalike, automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre, Shillovë, Gjilan.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!


Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara /Office of the General Secretary*

Nr.: 24/4565/MMPHI
Datë: 23.09.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

## VENDIM

1. Operatori, "M-Shkodrani" Sh.p.k., Gjilan, me nr. Prot. 24/577/MMPHI, **pajiset me vazhdimin e Lejes Mjedisore**, për veprimtarinë: Qendër grumbulluese të mbeturinave metalike, automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre, Shillovë, Gjilan, në ngastrat nr. P-70403064-01279-63; P- 70403064-01279-68; P-70403064-01279-73; P-70403064-01279-75, zona kadastrale Shillovë, Gjilan.

2. Operatori obligohet:

2.1 Të bënë mbikëqyrjen në vazhdim të sistemimit të mbeturinave metalike në platetë e sipërfaqes operuese dhe të sistemohen pjesët e çmontuara në hapësirat e mbyllura;

2.1. Në mënyrë të rregullt të mirëmbahen dhe basenet për seperimin dhe sedimentimit e vajrave, të bëhet zbrazja e tyre në vazhdimësi nga kompania e kontraktuar;



Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

2.1. Në mënyrë të rregullt të mirëmbahen dhe basenet për seperimin dhe sedimentimit e vajrave, të bëhet zbrazja e tyre në vazhdimësi nga kompania e kontraktuar;
2.2. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit të mjedisit;
2.3. Të kontrollohen në vazhdim kolektorët për grumbullimin e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e grumbullimit të mbetjeve të metalit;
2.4 Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

**A r s y e t i m**

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin është konstatuar se "M-Shkodrani" Sh.p.k., Gjilan, me nr. Prot. 24/577/MMPHI, për veprimtarinë: Qendër grumbulluese të mbeturinave metalike, automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre, Shillovë, Gjilan,në ngastrat nr.P-70403064-01279-63; P- 70403064-01279-68; P-70403064-01279-73; P-70403064-01279-75, zona kadastrale Shillovë, Gjilan, plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.19/1033/2-ZSP/344/19, të lëshuar me datë: 01.07.2019;
- Aktvendim nga Komuna Gjilanit nr.14-141013-1043/19, të lëshuar me datë:20.11.2019;
- Kontratë me Kompaninë, "Kanalprofis" për largimin e vajrave nga gropat sedimentuese;

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për vazhdimin **e Lejes Mjedisore**.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

**Këshilla Juridike**: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Afrim Murati

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:
- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Gjilan;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së



Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/